
REKOMANDIMET NGA KONFERENCA E SHTATË NDËRKOMBËTARE "SFIDAT E MOBILITETIT NË TRANSPORT DHE SIGURIA PUBLIKE", 24 JANAR 2020, VUSHTRRI

- Për të arritur Vizionin Zero (Vision Zero është një projekt multi-kombëtar i sigurisë së trafikut rrugor që synon të arrijë një sistem autostradash pa viktima ose lëndime serioze që përfshijnë trafikun rrugor), shtetet duhet të zbatojnë një qasje të integruar drejt sigurisë rrugore. Edukimi konsiderohet një pjesë thelbësore e kësaj qasje të integruar. Nëse krijohen zakone të mira kur fëmijët janë ende të vegjël, ka të ngjarë që ata të rriten për t'u bërë përdorues të përgjegjshëm në rrugë. Të integrohen programet mësimore në shkollat për sigurinë në komunikacion.
- Veprimet për të promovuar mbrojtjen e përdoruesve të rrugës: Zhvillimin e një programi specifik (rajonal/Kombëtar) për mbrojtjen e përdoruesve të rrugës, sidomos për mjetet motorike me dy rrota.
- Mungesa e vend ndaljeve/stacioneve për autobusë në disa vendbanime është arsye pse autobusët ndalen në vende të papërshtatshme/shirit qarkullues dhe rrezikojnë pjesëmarrësit në trafik.
- Mundësia e vendosjes së kamerave për mbikëqyrje të trafikut dhe sigurisë publike. Të rishikohen disa segmente rrugore në aspektin e projektimit inxhinierik, që praktikisht kanë krijuar vështirësi në qarkullim si dhe në disa raste edhe aksidente.
- Të bëhet një analizë e gjendjes së tërësishme të rrugëve në komunën e Prishtinës me qëllim të identifikimit të dëmtimeve dhe nevojave për sinjalizim dhe krahas kësaj të bëhet prioritizimi, si dhe të bëhet përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe sinjalistikës rrugore si dhe identifikimi i vendeve me rrezikshmëri dhe trajtimit të tyre.
- Shenjat e trafikut janë vendosur në rrugë për të siguruar informacion të mjaftueshëm dhe për të siguruar sigurinë e pjesëmarrësve në rrjedhën e trafikut. Dukshmëria e shenjave të trafikut është i dedikuar për të siguruar që shoferët të reagojnë me kohë, dhe kjo është arsyeja kryesore që ato janë bërë nga materiale retrorefletive. Prandaj duhet që të bëhet fillimin i matjes së retroreflektivitetit të të gjitha shenjave të trafikut,

si ato në fazën fillestare të vendosjes si dhe ato ekzistuese në tërë rrjetin rrugor të qytetit; zëvendësimin e shenjave rrugore me cilësi të ulët të retroreflektivitetit; inventarizimin sa më të shpejtë të të gjithë rrjetit të sinjalizimit dhe paraqitjen e tij në një Sistem të Menaxhimit Digjital; si dhe nxjerrjen e kriterëve dhe rregulloreve që e prezicojnë më saktë mënyrën e vendosjes, mirëmbajtjen si dhe zëvendësimin e shenjave rrugore të cilave ju ka rënë cilësia e retroreflektivitetit nën kriteret minimale.

- Të zhvillohet dhe adaptohet një model i analizës së sigurisë rrugore në nivel nacional me pjesëmarrje të institucioneve
- Lejet e për drejtimin e veturës nuk duhet të lëshohen pa certifikatë mjekësore nga një komision strikt verifikues. Të sëmurët me epilepsi dhe me sëmundje të rënda si të zemrës, trurit, malinje nuk duhet drejtojnë veturën as t'i lëshohet patentë shoferi, pa u vlerësuar nga aspekti mjekësor. Të inkorporohet si lëndë Ndhima e parë në nivelin shkollor mesëm ulët, e të lartë dhe në Universitete si dhe Siguria në komunikacion nivelin shkollor mesëm ulët si lëndë obligative. Të organizohen fushata kampanja edukative për pjesëmarrësit në komunikacion, në shkolla dhe komunitete.
- Me qëllim të përmirësimit të nivelit të sigurisë së çiklistëve në përgjithësi, rekomandohet implementimi sa më i madh planeve të qëndrueshme të mobilitetit në zona urbane, të cilat në fokus do të kenë akomodimin e lëvizjeve të pamotorizuara. Me plane të qëndrueshme urbane mund të arrihet inkurajimi i përdoruesve të rrugës për përdorimin e biçikletës për lëvizje dhe të ofrohet një mjedis komfort dhe i sigurt për të gjithë përdoruesit e rrugës, veçanërisht për lëvizjet e pa motorizuara.
- Ndërtimi i më së paku tre qendrave logjistike në karakter nacional ose internacional, do të ofronte të gjitha shërbimet e transportit të mallrave në një vend. Rregullimi i terminaleve ekzistuese i pasagjereve si dhe i mallrave, duke përmisuar infrastrukturën ekzistuese dhe aplikimin e sistemeve të reja teknologjike. Ndërtimi i rrjeteve rrugore si dhe rifunksionalizimi i hekurudhave në Kosovë por edhe në regjion, do ta bënte të mundur lidhjen e korridoreve ekzistuese, duke ndihmuar në integrimin e regjionit me pjesën tjetër të Evropës.

-
- Kompanitë e Shërbimeve Ujore kanë një potencial të madh për të kursyer para duke përdorur Programin e Efikasitetit të Energjisë, me 3% të të gjithë energjisë gjeneruese që shkon në shërbimet e Ujësjetësit dhe Kanalizimeve, marrja e pompave që funksionojnë mirë duhet të jetë një synim kryesor, më shumë se 90% e konsumit të energjisë elektrike nga Ujësjetësit dhe Kanalizimet e Ujërave të Ndotura konsumohet nga pompat.